



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË**

---

**AD/GJTHGJA.nr. 03/24**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi Y. Xh., avokat në Gjakovë, ndaj gjyqtares F. K., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 07 nëntor 2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Refuzohet** ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati Y. Xh., ndaj gjyqtares F. K., si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Me datën 21 tetor 2024 ankuesi Y. Xh., avokat në Gjakovë, ka dorëzuar ankesën disiplinore me propozimin që ankesa të aprovohet dhe shkelësve të ju shqiptohet masa disiplinore vërejtje publike me shkrim. Ankuesi me datë 25.10.2024 duke vepruar sipas kërkesës, e ka dorëzuar plotësimin e ankesës duke e precizuar se ankesa drejtohet ndaj gjyqtarëve të cilët e kanë pasur lëndën në shkallë të parë, saktësisht gjyqtarja A. S. dhe F. K. si dhe ndonjë gjyqtarë tjetër.

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr.03/24 me datën 21 tetor 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr.03/2024 të datës 21 tetor 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi, Y. Xh. avokat në Gjakovë, në ankesën e tij të dorëzuar me datë 21 tetor 2024 ka theksuar se bazuar në nenin 4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, *“Gjyqtarët dhe Prokurorët i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore për shkelje disiplinore në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligji”*, si dhe neni 5 shkeljet disiplinore për gjyqtar apo *“Gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse ai ose ajo shkel ligjin”* dhe ka propozuar që ankesa të

aprovohet dhe shkelësve të i shqiptohet masa disiplinore vërejtje publike me shkrim. Ka shtuar se ankuesi, avokati Y. Xh. ka paraqitur padinë C.nr.936/20, gjithashtu edhe propozimin për masën e sigurisë, mirëpo nuk është caktuar seanca edhe pse masa e sigurisë trajtohet urgjentisht, andaj është hedhur padia pa u siguruar prova. Gjykata e ka kthyer në rigjykim duke e detyruar për të siguruar provën, për çka gjithë kjo vonës ka bërë që pronari i ri ta shkatërroj shtëpinë, ne e kemi shitur shtëpinë pas vdekjes së prindërve në vitin 2021. Ka shtuar se roli i gjyqtarës si përfundimtar shprehet në kundërshtim me autorizimin të cilin e jep LPK-ja *“E drejta për një proces të rregullt”* apo neni 6 i Konventës Evropiane na ofron garancitë që të legjitimohet çdo veprim dhe të vazhdoj procesin tutje gjykata. Ka shtuar se *“Padrejtësia është gjëja më e keqe që mund të ju ndodh njerëzve në këtë botë”*, andaj aprovimi i kësaj ankese do të ishte një preventivë për të ndaluar kundërligjshmëritë dhe arbitraritetin si formë e shprehur e gjyqtarëve.

Po ashtu, ankuesi duke vepruar sipas kërkesës për plotësimin e ankesës, me datë 25.10.2024 në gjykatë e ka dorëzuar plotësimin e ankesës në të cilën ka theksuar se shkelja disiplinore është neni 5 par.1 nënpar.1.2, ankesa drejtohet ndaj gjyqtarëve të cilat e kanë pasur lëndën në shkallën e parë, saktësisht gjyqtarja A. S. dhe gjyqtarja F. K., ose dhe ndonjë gjyqtarë tjetër për të cilin nuk ka informacion, kuptohet në shkallë të parë. Ka shtuar se *“është shumë e rëndë që të më digjet shtëpia, edhe pse nuk kompensohem unë, detyrohem që të paguaj taksë, kjo nuk ndodhë askund në botë, në lidhje më këtë lëndë ku paditëse është U. G. Xh. dhe i padituri “D. to D.”*. Ka theksuar se *“kam kërkuar sigurimin e provës e cila është masë urgjente, ku duhet të caktohet seanca menjëherë meqenëse kërcënohet rreziku i shkatërrimit të provës, gjyqtarja nuk e cakton. Gjithashtu me urgjencë kam kërkuar caktimin e seancës duke ua bërë me dije gjyqtarëve se është shitur shtëpia dhe mund të shkatërrohet në çdo moment, por kjo ka shkuar në vesh të shurdhër, dhe pas 4 viteve caktohet seanca për sigurimin e provës ku shtëpia është e shitur dhe kemi qenë 2 hisetar, vëllai ka banuar me qira dhe e kishim të pamundur të bëjmë shtyrjen e shitjes së shtëpisë, pasi vëllai banonte me qira.”*

Ankuesi duke vepruar sipas kërkesës së dytë të datës 25.10.2024, për plotësimin e ankesës gjegjësisht për të siguruar dëshminë që ka parashtruar kërkesë për sigurimin e provës me datë 04.11.2024, në gjykatë e ka dorëzuar parashtrësën me të cilën ka theksuar se kërkesën për sigurimin e provës e kam dorëzuar, mirëpo lëndën nuk po mundem të e gjej, ashtu që ka kërkuar ta kërkojmë në SMIL, meqenëse shpesh ndodh të mos jetë në shkesat e lëndës mirëpo kur e shikojnë gjyqtarët në SMIL e gjejnë. Ka theksuar se *“edhe një herë me përgjegjësi them se e kam dorëzuar në këtë lëndë mirëpo nuk po mundem të e gjej lëndën në fjalë”*.

Gjyqtarja Fellanza Knushaj, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankuesit ndër të tjera ka theksuar se *“këtë lëndë me numër C.nr. 936/20 ku paditëse është Urata Gola, të cilën e përfaqëson Y. Xh. avokat në Gjakovë, kundër të paditurës “D. to D.” në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit e ka pranuar me datë 21.08.2023, ndërsa seancën përgatitore e ka caktuar me datë 12.09.2024. I autorizuari i paditëses, avokati Y. Xh. pas caktimit të seancës përgatitore ka dorëzuar një parashtrësë përmes së cilës e ka njoftuar gjykatën që e tërheq padinë në këtë çështje kontestimore, e ku në seancën përgatitore pas konstatimit të gjykatës lidhur me parashtrësën e të autorizuarit të paditëses se e tërheq padinë, i autorizuari i të paditurës ka kërkuar shpenzimet procedurale”*. Ka shtuar se *“gjykata përmes aktvendimit C.nr. 936/20 të datës 15.10.2024, ka konsideruar të tërhequr kërkesëpadinë e paditësit dhe ka obliguar të njëjtin në pagesën e shpenzimeve procedurale ashtu siç e parashohin dispozitat e nenit 456 të LPK-së”*.

*Ka shtuar se “në shkresat e kësaj lëndë nuk ka pasur kërkesë për caktimin e masës së sigurisë dhe nuk ka kërkesë për sigurim prove, andaj konsideroj se veprimet e ndërmarra si gjyqtare e çështjes janë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore”.*

Kryetari i Gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit, deklaratës së gjyqtares, si dhe shkresave të lëndës C.nr. 936/2020, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se në këtë lëndë civile ka kërkuar sigurimin e provës e cila është urgjente dhe seanca nuk është caktuar dhe bazuar në shkresat fizike të lëndës, si dhe ato të regjistruara me programin elektronik SMIL, askund nuk është konstatuar se ankuesi si përfaqësues i palës paditëse në këtë çështje juridiko-civile ka parashtruar kërkesë për sigurimin e provës, ashtu siç ai pretendon. Fakti se ankuesi nuk ka paraqitur kërkesë për sigurimin e provës, argumentohet edhe nga deklarata e gjyqtares F. K., e cila ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk ka pasur kërkesë për caktimin e masës së sigurisë si dhe nuk ka kërkesë për sigurimin e provës, e po ashtu edhe vetë ankuesi i cili duke vepruar sipas kërkesës së kryetarit të Gjykatës për të ofruar dëshmi se ka parashtruar kërkesës për sigurimin e provës me shkresën e datë 04.11.2024, nuk ka arritur që ta dëshmojë që ka paraqitur një kërkesë të tillë.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se Gjykata e Apelit e ka kthyer këtë çështje në rigjykim duke e detyruar të siguroj provën, mirëpo nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr. 3359/20, është e vërtetuar se është e vërtetë se kjo lëndë është kthyer në rigjykim dhe rivendosje por askund në vendimin e Gjykatës së Apelit nuk është cekur se kjo Gjykatë ka vlerësuar apo e ka trajtuar sigurimi i provës ashtu siç pretendon ankuesi, por nga ky aktvendim konstatohet se Gjykata e Apelit ka sugjeruar që gjatë zhvillimit të procedurës të kërkohet zyrtarisht provat duke ju referuar dispozitës së nenit 332 të LPK-së, por asesi nuk ka sugjeruar procedurën e veçantë të sigurimit të provës (paraprovës), ashtu siç pretendon ankuesi.

Bazuar në shkresat e lëndës është e konstatuar se ankuesi si përfaqësues i palës paditëse ka parashtruar padi për kompensim-shpërblim i dëmit dhe askund qoftë në padi apo në plotësim të padisë së bërë nga ankuesi, si përfaqësues i palës paditëse, nuk është e konstatuar se ka bërë kërkesë për sigurim prove ashtu siç deklaroi ankuesi në ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarëve që kanë qenë të ngarkuar me këtë lëndë, si ndaj ish gjyqtares A. S. e cila është e pensionuar me datë 21.07.2023 dhe ndaj gjyqtares F. K., e cila me këtë lëndë është ngarkuar me datë 21.08.2023, e cila pasi ankuesi e ka tërhequr padinë me datë 15.10.2024 e ka nxjerr aktvendimin me të cilën është konstatuar e tërhequr padia në këtë çështje juridiko-civile.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet qoftë të ish gjyqtares e cila është pensionuar apo të gjyqtares së tanishme e cila është ngarkuar me këtë lëndë nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezultoi se veprimet

e ndërmarra nga gjyqtarja F. K., përbëjnë bazë për inicimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**AD-GJTHGJA.nr. 03/24, datë 07 nëntor 2024**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Nikollë Komani**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Parashtruesit të ankesës*
- 3. Gjyqtarës*